



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1409/2 Prot.

Tiranë, më 27-05 2025

VENDIM

Nr. 62 dt. 27.05 2025

“PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.56, DATË 25.04.2025
“PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E
GRADËS SHKENCORE DOKTOR, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES
DHE FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT, PËR VITET
AKADEMIKE 2024-2029”

Mbështetur në nenet 35, 38, 77 paragrafi 4, 79 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Udhëzimin e MAS nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 20, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe 64 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.05.2025,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të Vendimit të Senatit Akademik nr.56, datë 25.04.2025 si më poshtë vijon:

Ishte: Miratimin e programeve të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore doktor, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, për vitet akademike 2024-2029”.

Bëhet: Miratimin e Projekteve Kërkimore Shkencore të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” në “Shkenca Sportive” në fushën e “Edukimit Fizik dhe Sportit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes si dhe në fushën “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, për vitet akademike 2024-2029”

2. Ky Vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

3. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. AGRON KASA

